



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 97
Prishtinë, më 21.1.2014, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dhurata Kryeziu-OSBE, Sanije Berisha-OSCE, Luanda Domi- DCAF, Avni Arifi-CDF dhe Naim Hoxha-OSBE.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antingona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 17.12.2013 dhe 24.12.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2013;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-242, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04 L-248, për ratifikimin e marrëveshjes për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive;

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04 L-241 për Armë;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari e nisi takimin e radhës me miratimin e rendit të ditës, duke kërkuar nga të pranishmit pajtimin me këtë rend të ditës.

Vjollca Krasniqi- Në emër timin dhe të z. Anton Quni, vlerësojmë se pasi materialet të cilat i kemi sot për shqyrtim, i kemi marrë me vonesë dhe nuk kemi mundur ti shqyrtojmë, dhe pasi sot është përvjetori i vdekjes së Presidentit Dr. Ibrahim Rugova, propozoj që pikat e propozuara për këtë rend dite të shtyhen për mbledhjen e radhës së Komisionit, pasi që nuk do të mund të qëndrojnë deri në fund të këtij takimi.

Kryetari- Konsideroj se materialet janë marrë me kohë dhe pasi në rend dite janë tre projektligje të cilat janë në shqyrtim në parim, për të cilat nuk duhet shumë kohë, propozoj të vazhdojmë me këtë rend të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit, të mbajtura më 17.12.2013 dhe më 24.12.2013;

Kryetari, konstatoi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura , më 17.12.2013 dhe më 24.12.2013.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2013;

Kryetari- Raporti vjetor i Punës për vitin 2013, përmbledh të gjitha aktivitetet e realizuara nga ana e Komisionit. Po ashtu, në Komision kemi shqyrtuar informatën ku janë përfshirë aktivitete e realizuara për vitin 2013, të cilat tashmë janë në raportin përfundimtar. Më tej, e hap debatin, nëse ka vërejtje apo plotësime për raportin.

Fatmir Xhelili- Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2013 përmbledh të gjitha aktivitetet të cilat i ka zhvilluar Komisioni, prandaj propozoj që të hidhet në votim për miratim në Komision.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për vitin 2013.

- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-242, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë, për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.**

Kryetari- Konsideroj se si Komision Funksional, duhet të vazhdojmë tutje punën me këtë projektligj dhe propozoj miratimin në parim të tij.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me tetë(8) vota për dhe një(1) abstenim (Vjollca Krasniqi) nxori këtë

Rekomandim

Të miratohen, në parim, Projektligjin nr. 04/L-242, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë, për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimi në parim i këtij projektligji.

Tutje propozoj formimin e grupit të punës për shqyrtimin e këtij projektligji.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-242, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

Grupi punues ka këtë përbërje: Anton Quni, kryesues, Fatmir Xhelili, Rexhep Selimi, Goran Marinković dhe Danush Ademi, anëtarë.

5. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit nr. 04 L-248, për ratifikimin e marrëveshjes për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Kryetari- Pasi ky projektligj është marrëveshje ndërmjet dy shteteve, nuk do të ketë nevojë të kalojë në lexim të dytë, por vetëm në lexim të parë, dhe se miratimi i tij bëhet me 2/3 (dy të tretat e votave) të Kuvendit, ne si Komision rekomandojmë që ai të dërgohet në seance plenare.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me tetë(8) vota për dhe një(1) abstenim (Vjollca Krasniqi) nxori këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 04 L-248, për ratifikimin e marrëveshjes për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimi në parim i këtij projektligji.

2. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit nr. 04 L-241 për Armë;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me tetë(8) vota për dhe një(1) abstenim(Vjollca Krasniqi) nxori këtë

Rekomandim

*Të miratohet, në parim, Projektligjin nr. 04/L-241 për Armë.
I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratim në parim i këtij projektligji.*

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

*Formohet Grupi i Punës për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-241 për Armë .
Grupi i punës ka këtë përbërje: Rexhep Selimi, kryesues, Fatmir Xhelili, Goran Marinković dhe Danush Ademi, anëtarë.*

2. Të ndryshme.

Kryetari njoftoi se Strategjia Legjislative për vitin 2014, tashmë ka ardhur dhe Projektligji që pritet të vijë në shqyrtim në Komision, është projektligji për pensionimin e zyrtarëve policorë të Kosovës, por ka mundësi që të kemi edhe projektligje të tjera.

Në javën e ardhshme, në mbledhjen e radhës së Komisionit propozoj të kemi në diskutim planin e punës së Komisionit për vitin 2014. Gjithashtu, ju njoftoj që ka ardhur raporti vjetor për vitin 2013 nga Komandanti i FSK-së dhe të ftohet në Komision për raportim. Po ashtu njoftoi se më 16 janar 2014, ka realizuar një vizitë në Bruksel, në kuadër të Dialogut të Strukturuar për rendin dhe ligjin si dhe për bartjen e kompetencave nga EULEKS-i në institucionet vendore.

Ganimete Musliu- Propozoj që nga ana e Komisionit të merret iniciativë për ngritjen e një debati parlamentar për çështjen e ish- pjesëtarëve të TMK-së, ose edhe trajtimin e kësaj çështje në Komision, duke dhënë kontributin si anëtarë të këtij Komisioni, pasi për këtë çështje janë drejtuar kërkesa nga ish-pjesëtarët e TMK-së.

Rexhep Selimi- Theksoi se edhe në adresë të tij kanë arritur kërkesa nga ish- pjesëtarët e TMK-së, të cilët për shkak të ligjit dhe moshës që kanë nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit dhe nuk kanë përkrahje. Ligji për pensionet i ish-pjesëtarëve të TMK-së, që rregullon këtë çështje, personat që kanë bërë kërkesë nuk mbulohen nga ky ligj, pasi kur kanë dalë nga ish-TMK-ja kanë qenë në moshë të re. Përveç që e mbështes idenë që të ketë debat parlamentar, ne si Komision mund të marrim iniciativë për plotësim-ndryshimin e ligjit i cili e rregullon atë fushë. Numri i këtyre personave nuk është i madh, prandaj integrimi i tyre nuk do të kishte implikime të mëdha financiare. Më tepër se sa për një debat parlamentar, jam për nismën për plotësim-ndryshimin e ligjit për pensionimin e ish-pjesëtarëve të TMK-së, në mënyrë që gjatë sesionit pranveror të përfundojë ky plotësim-ndryshim i ligjit aktual.

Fatmir Xhelili- Me konsideratën më të lartë për të gjithë ata që kanë shërbyer në TMK, para se të marrim iniciativën, qoftë për debat parlamentar ose për plotësim-ndryshimin e ligjit aktual, duhet të kemi të dhëna për numrin e këtyre personave, grup-moshën, rrethanat dhe kushtet e tyre, pasi duhet marrë parasysh buxhetin e shtetit tonë dhe kategoritë e tjera, siç është kategoria e veteranëve të luftës, që duhet të rregullohet.

Sugjerimet e Komisionit për të punësuar një numër të caktuar të kësaj kategorie, qoftë edhe në institucione private, do të ishte një zgjidhje adekuate për këtë çështje.

Rexhep Selimi- Krahas propozimit që bëra për këtë çështje, ndoshta edhe nga ana e Kryetarit, do të mund të bëhet një takim me këta persona që të dëgjohen, në mënyrë që të merren të dhënat e sakta, për numrin, moshën, sa kanë qenë pjesëtarë të komponentës civile, pasi kërkesat e tyre janë të arsyeshme.

Fatmir Xhelili- Propozoj që paraprakisht të merren të dhëna nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për të parë nëse këta persona gëzojnë beneficione.

Ganimete Musliu- Pajtohem me z. Fatmir Xhelili, që fillimisht të kërkohen të dhëna për këtë kategori dhe gjithashtu të shikohet mundësia riaftësimit dhe inkuadrimit të tyre.

Konsideroj se përmes një debati parlamentar për këtë çështje, do të mund të arrinim në një përfundim, fillimisht në Komision e pastaj në Kuvend, që përmes grupeve parlamentare të gjendet një zgjidhje për këtë kategori, pasi numri i tyre nuk është i madh, por janë në gjendje të vështirë.

Konsideroj se kjo kategori duhet të trajtohet përmes Komisionit dhe në mënyrë individuale, prandaj nëse nga ana e Komisionit merret iniciativë do ta mbështes, duke dhënë kontributin në mënyrë racionale në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari- Ju njoftoj se për këtë çështje kemi pranuar një kërkesë të një numri të caktuar të ish-pjesëtarëve të TMK-së, për të cilët konsiderojmë se janë në pozitë të vështirë materiale.

Duke qenë se jemi Komision mbikëqyrës ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së FSK-së, çështja e pensioneve mbulohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në kuadër të Kuvendit. Ne si Komision mund ta trajtojmë këtë çështje, por duhet që të dihet saktë numri i tyre, statusi aktual dhe nëse janë në marrëdhënie pune, prandaj jam dakord që mund ti thërrasim dhe ti dëgjojmë nevojat e tyre dhe çfarë mund t'ju ndihmojmë në këtë drejtim.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi